

URDHËR
Nr. 339, datë 22.5.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR MBYLLJEN
APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalía e fundit e pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“Përrjashtim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë 23 maj 2020, lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 21:00.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**